REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br 92/24
Nr. i fq. / Br. st -1-
Data: / Datum 20.05.2024
VUSHTRRI - VUČITRN

**REPUBLIKA E KOSOVËS** **KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI**

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

**Ju fton**

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **30 maj 2024 (e enjte), me fillim në ora 10:00.**
Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

**R E N D  D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 25 prill 2024.
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, për rregullimin e kanalizimit në Rr. "Enver Musa" në Vushtrri.
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ndarjen e mirënjohjeve dhe dekoratave për nder të 17 qershorit ditës së çlirimit.
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor për punën e Ndërmarrjes Regjionale të Mbeturinave KRM "Uniteti" për vitin 2024.
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së – dega në Vushtrri.
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave lidhur me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim.
7. Pyetje dhe përgjigje.

**Melihate Basholli-Latifi**

**Kryesuese e Kuvendit të Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br 91/24
Nr. i fq. / Br. st -1-
Data: / Datum 20.05.2024
VUSHTRRI - VUČITRN

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA VUSHTRRI**
**OPŠTINA VUČITRN**

| | |
|---|---|
| **PËR:** | **Kuvendin e komunës** |
| **NGA:** | **Melihate Basholli Latifi** ____________<br><br>**Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë** |
| **PËRMES:** | **Sekretarisë së Kuvendit** |
| **TEMA:** | **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 17.05.2024** |

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **17 maj 2024** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për rregullimin e kanalizimit në rr. "Enver Musa" në Vushtrri.
   ***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***
   ***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

2. Shqyrtimi i Raportit vjetor për punën e Ndërmarrjes Regjionale të Mbeturinave KRM "Uniteti" për vitin 2024.
   ***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***
   ***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

3. Shqyrtimi i kërkesës së Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së – dega në Vushtrri.
   ***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***
   ***Që Drejtoria për Buxhet dhe Financa ta përgatis propozimin për caktimin e shumës financiare dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

***Komiteti për Politikë dhe Financa kërkoi që për kuvend të përgatitet Propozim-vendimi për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve për "Ditën e Çlirimit".***

*Me respekt!*

**REPUBLIKA E KOSOVËS** **KUVENDI I KOMUNËS – VUSHTRRI**

# PROCESVERBAL
# NGA MBLEDHJA E IV E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 25 PRILL, 2024

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën **10:15.**
Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:
Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Alban Bajrami, Arlind Gogolli, Basri Menxhiqi, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Faton Hyseni, Gentiana Rama, Gresa Muli, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Fakete Dushi, Jeton Gjaka, Mek Selaci, Refik Maloku, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nasuf Aliu**,** Nurie Halili, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Shkelzen Xhaferi, Spasoje Stefanoviq, Sylejman Meholli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

**Mungoi:** Fatmire Cecelia.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 33 anëtarë të kuvendit, kuorum i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës z. Shpëtim Zhegrova, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit-** në fillim të mbledhjes prezantoi para kuvendit pikat e dërguara për rendin e ditës, në të ndryshme.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-** duke iu adresuar Kuvendit dhe qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë deklaroi: kryetari Idrizi po e mbyll edhe vitin e 3-të të qeverisjes pa vizion e koncept, duke vulosur dështimin e plotë të përformancës së vet. Le t'i bëjmë publike disa gjëra që kryetari ka provuar ti mbajë larg publikut dhe ti kalojë në heshtje.
**1.** E kishte prioritet arsimin, deklaronte se ai është vetë profili i kësaj fushe! Çka ndodhi, çfarë ndryshoi për tri (3) vjet në këtë fushë?! Ndryshoi 3 drejtorë, kurse asambelistin e subjektit të vet e zhvendosi nga kjo sallë e direkt në pozitën e drejtorit të Gjimnazit. Përtej këtij politizimi klasik, kryetari Idrizi harroi se ekziston ligji lidhur me kriteret dhe standardet, se drejtor shkolle nuk mund të jet dikush që në 3 vitet e fundit ka ushtruar post politik.
**2.** Shkarkoi apo liroi nga detyra dy drejtorë të Inspekcionit, pa dalur kurrë me një sqarim për qytetarët. Nëse shkarkohen dy drejtorë të një drejtorie kaq të ndjeshme, a ishte dashtë që së paku

të ketë një sqarim publik, pse ndodhi?! A pati korrupsion? A pati mungesë performance? A pati probleme me ligjin, apo nuk i zbatoi detyrat?!
**3.** Kryetar Idrizi, ndryshove 3 ose 4 drejtorë, janë bërë shumë, kanë filluar të na ngatërrohen edhe neve në Drejtorinë e Prokurimit, në drejtorinë e tenderëve. Qytetarë të dashur, për ju që mund të keni dilema se cili është roli i kësaj drejtorie; një qytetar i zhgënjyer i Vushtrrisë që ju kishte votuar juve, me tha një ditë me mllef: qysh me i besu Ferit Idrizi-t që nuk ndikon në prokurim dhe tenderë, kur deri më tani i ndërroi 3-4 drejtorë, pikërisht te tenderët. Më ka bërë borxhli me të pyet me cilin drejtor je ma i kënaqur në prokurim, nga këta që i ke provuar?!
**4.** Dy drejtorë në Kadastër, dy në Financa, dy në shëndetësi, pa asnjë sqarim publik kryetar. Dil sqaroju qytetarëve pse këto dorëheqje/shkarkime apo rokada. Nuk është qeverisja humor me i ndryshuar e provuar drejtorët herë një drejtori herë në tjetrën, mos po rehatohen dikund. Ti e ke kthyer në humor qeverisjen e Vushtrrisë dhe në një rreth-rrotullim të drejtorëve rreth drejtorive, me stilin po shetitem rreth drejtorive ndoshta ndonjëra po del të jetë stabile. Çfarë vizioni është ky, thuaja qytetarëve, mos u fsheh?!
**5.** Ke themeluar drejtori të re pa planifikim buxhetor, pa vizion, pa asnjë sqarim ndaj qytetarëve se pse u shtua kjo drejtori? Sa është buxheti i kësaj drejtorie? Cili është roli dhe detyrat e kësaj drejtorie? Sa resurse humane ka kjo drejtori? Ku është zyra e kësaj drejtorie?
- Kryetar a ke bërë këtë drejtori për interes të qytetarëve a për interesa politike të Nismës-SOCIALDEMOKRATE, e si vend pune për drejtorin?! Nëse e ke bërë për interesa qytetare, për çka e di se kështu përgjigjesh, a ish dashtë bre me dal me një prezantim publik, cili është interesi?! Pse po shtohet drejtoria? Çka do t'iu shërbei drejtoria qeverisjes dhe zhvillimit?! Kryetar, përballu me të vërtetën dhe realitetin edhe nëse është i hidhur mos hesht, mos u fsheh, mos u viktimizo. Këto gjëra për publikun janë më me interes, se sa me postu në fb me kënd ke bërë iftar në ramazan. Çfarë shembulli qeverisje është ky, ku as kryetari as drejtori nuk paraqesin vizionin e një drejtorie të re që e kanë themeluar?! Nëse nuk ka vizion as kompetenca, pse e bëtë atëherë?!
**6.** Kryetar, në hyrje të Vushtrrisë, te pompa e derivateve "Fati Petrol" i ke qitë do konstrukte metalike qe disa muaj për një mega-projekt, me bërë një sinjalizim për qytetarët "hyrje në Vushtrri". Megjithëse sinjalistika nuk u krye tash e sa muaj, cilit qytetar hynë në atë konstruksion, kalon nëpër një kanal (gropë) të tmerrshme të prerjes se asfaltit, që nuk u rregullua asnjëherë që nga prerja e tij, tash e disa muaj. Kjo "hyrja në Vushtrri" që po flas, është pasqyra më e mire se si është qeverisja jote, pra, kujdes, po hyni në Vushtrri, në qytetin e gropave dhe kanaleve të Feritit, kurse përshëndetja më e mirë për qeverisjen tuaj është përshëndetja e qytetarëve, sa herë e kalojnë atë kanal e sidomos në ditët si këto me shi, kur shiu e thellon gropën duke e thelluar edhe thelluesin e përshëndetjes. Kolonën që e krijon, as që ja vlenë me e diskutu. Të dashur qytetarë, lista e gjërave që dëshmojnë qeverisjen pa vizion e koncept të Ferit Idrizit janë tashmë të shumta po e ndali me kaq për shkak se nuk më mjafton minutazha qe kam në dispozicion.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**pasi i përshëndeti të pranishmit në adresimin e tij drejtuar kuvendit dhe qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë deklaroi si vijon: projekti i vetëm në të cilin po shpreson Kryetari i Komunës është projekti i sheshit, sepse në projektet dhe premtimet e tjera kryetari ka dështuar. Ka dështuar në 50 premtimet, për 50 ditët e para, ka dështuar në projektin e ujësjellësit, dështim edhe me 99 fijet të cilat pretendonte që i kishte me qytetarët e Vushtrrisë, dështim në realizim të buxhetit dhe vetëm dështim. Sheshet për PDK-në janë specialitet, sidomos në qytetin tonë, ku i njëjti shesh për një periudhë të shkurtë kohore po ribëhet, po nga ky pushtet. Kryetar, ju po krenoheni shumë me projektin e sheshit, por pyetja ime është se a po krenohen njëjtë si ju edhe qytetarët, të cilët kanë apo më mirë të themi kishin biznese në shesh. A jeni në dijeni që shumica e bizneseve në atë zonë i kanë mbyllur bizneset e tyre, a keni harruar që po këtyre

bizneseve ju kishit premtuar subvencionim të qirasë mujore të paktën për periudhën e punimeve në shesh? Ku është ky vendim Kryetar, pse nuk e keni marrë këtë vendim? Apo edhe ky vendim e ka fatin e njëjtë sikur shumë vendime tjera të marra nga ana juaj? Ku mbeti vendimi për subvencionimin e fëmijëve të posalindur? Apo, edhe për këtë nuk kemi përgjigje? Të dashur qytetarë të Vushtrrisë, tashmë jemi mësuar që Kryetari premton vendime dhe nuk i merr kurrë ato vendime, ose edhe nëse i merr, të njëjtat i anulon brenda javës. Tashmë jemi mësuar me ndërrimin e drejtorëve komunal në baza mujore, për të cilat ndërrime dhe shkarkime Kryetari asnjëherë nuk jep shpjegime. Kryetar, pse u shkarkua drejtori i Inspekcionit, cilat janë arsyet e shkarkimit, ku nga informatat që i kemi ky drejtor ka qenë njëri prej të paktëve në kabinetin e juaj i cili ka pasur një angazhim ditor dhe ka bërë një punë të mirë? Apo ndoshta ka ardhur koha që edhe këtë drejtori ta udhëheq “Jokeri”? Kryetar, qytetarët e Vushtrrisë, por edhe ne anëtarët e Kuvendit, kemi nevojë për këto përgjigje. Çfarë po ndodh me ujin Kryetar, a keni harruar premtimin e juaj që brenda gjashtë muajve i tërë qyteti i Vushtrrisë do të ketë ujë, ku edhe sot pas më shumë se dy viteve qeverisje nga ana juaj nuk është bërë asnjë hap në këtë drejtim, aty ku e kemi lënë aty ka mbet?!
**Edona Gashi, anëtare e kuvendit-**fillimisht tha se vetë rendi i ditës së kësaj mbledhje me kaq pak pika për shqyrtim, tregon se sa është duke u punuar nga ana e kësaj qeverie komunale. Pastaj shtoj se ajo çka e ka karakterizuar këtë qeveri është ndërrimi me rekord i drejtorëve komunal, si dhe kositja e barit dhe mbjellja e luleve gjatë ditëve të dimrit. Pastaj pyeti lidhur me kontratën për parkingun nëntokësor në vlerë prej 2.7 milionë euro dhe duke kalkuluar që do të ndërtohen rreth 100 parkingje për automjete, atëherë i bie që vlera për një parking është 27,000 € apo 1500 € për $m^2$, ndërsa çmimi i tregut të ndërtimit është 900 € $m^2$ , andaj shtohet pyetja se përse kaq shtrenjtë po paguan komuna, me taksat e qytetarëve?!
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**pasi i përshëndeti të pranishmit deklaroi se në mbledhjen e muajit dhjetor 2023, në bazë të propozimit të grupit kuvendar të LVV-së në kuvendin e Komunës së Vushtrrisë, është diskutuar për gjendjen e rënduar të bizneseve që shtrihen përgjatë sheshit “Adem Jashari” ku është duke u ndërtuar, realizuar projekti kapital <parking nëntokësor>, që është ndikuar veprimtaria e këtyre bizneseve, dhe në rastin konkret kryetarit të komunës i është rekomanduar që të bëj një analizë të hollësishme buxhetore, që për vitin fiskal 2024, të iu ofrohet një ndihmë financiare, apo mbulimi i qirasë për bizneset që shtrihen përgjatë sheshit “Adem Jashari” në Vushtrri, konkretisht në pjesën ku po realizohet projekti <ndërtimi i parkingut nëntokësor>, pasi që bizneset që shtrihen në perimetrin ku po ndërtohet ky parking, janë dëmtuar si rezultat i zhvillimit të punimeve dhe mbylljes së rrugës e që në rastin konkret është zvogëluar qarkullimi i njerëzve dhe kësisoj është penguar dhe kufizuar në masë të madhe zhvillim i qarkullimit biznesor. Kryetari i komunës, në po të njëjtën seancë është zotuar se pasi të bëjë një analizë financiare të sjell para kuvendit një propozim për të ti subvencionuar këto biznese, por edhe pse kanë kaluar pesë muaj nga ajo kohë akoma nuk kemi asgjë konkrete dhe nuk ka asnjë informacion për këtë çështje. Prandaj pyeti kryetarin e komunës, a e keni bërë analizën financiare dhe kur do ti ndihmoni këto biznese?! - sepse gjendja e tyre është renduar tej mase dhe praktikisht këto biznese janë në prag të falimentimit.
**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-**pasi i përshëndeti të pranishmit, deklaroi duke ngritur çështjen se nuk po kemi respektim të planit të punës së kuvendit, duke mos proceduar pikat që janë në planë e ndër to ka qenë edhe raporti për N.P.L. “Përparimi” që ka qenë i planifikuar për muajin mars 2024, kjo është gabim sepse kjo pikë është dashur të sillet në kuvend, pasi që kuvendi si organi më i larë i Komunë ka të drejt të mbikëqyrë punën e ndërmarrjeve publike të cilat vet i themelon. Tutje shtoj se, ky kuvend e ka subvencionuar Ndërmarrjen “Përparimi” disa herë, por asnjëherë nuk kemi marr raport se si janë shpenzuar ato mjete, ndërsa kur është votuar për këto subvencione ishin

parashutuar nga ana e tij tetë kushte por të cila nuk janë zbatuar asnjëherë. Prandaj ai nuk do të votoj më deri sa nuk plasohen këto kushte të cilat i ka parashtruar. Çështja tjetër që e parashtroj është në lidhje me votimin në kuvend me opsionet "për", "kundër" dhe "abstenim", dhe në këtë kontekst shtroj se me çfarë të drejte ata të cilët nuk votojnë i konsiderojnë si abstenim, sepse ata të cilët nuk votojnë nuk numërohen në votë, por vota abstenim mundëson të krijon kuorum, ndërsa nëse mbetet votë neutrale konsiderohet se nuk ka votuar fare. Rasti më i freskët është ai nga mbledhja e kaluar kur u kalua për rend dite çështja e zonës ekonomike me 16 vota "për" edhe pse është në kundërshtim me ligjin.
**Refik Maloku, anëtar i kuvendit-**tha se, ndërrimet dhe shkarkimet e drejtorëve komunal, nga ana e kryetarit të komunës, janë bërë në drejtoritë kyçe të sistemit komunal si prokurimi, ku janë tenderët, arsimi ku janë punësimet si dhe inspektimet aty ku bëhen pazare të ndryshme. Në këtë aspekt ka dyshime se po bëhet fjalë për gjëra jo të mira dhe keqpërdorime. Pastaj tha se është shkelur premtimi i kryetarit të komunës për furnizim me ujë të pijes sepse kishte premtuar se për gjashtë muaj do të bëhet përfundimi i kyçeve dhe furnizimi me ujë të pijes, por tash më kanë kaluar 30 muaj prej se ka ardhur kryetari në udhëheqje të komunës dhe asgjë nuk është bërë në këtë drejtim. Lidhur me shtimin e iftareve në muajin e Ramazanit, tha se kryetari i komunës me këto iftare po bënë fushatë me para të taksapaguesve të komunës.
**Ali Januzi, anëtar i kuvendit-**prezantoi një kërkesë para kuvendit nga ana e punëtorëve të Ndërmarrjes "Uniteti", të cilët kërkojnë të lirohen nga taksat për mbeturina, për shkak se pagat e tyre janë të ulëta dhe gjendja e tyre sociale dhe ekonomike është e rënduar.
**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-**pyeti kryesuesen e kuvendit për pikën e rendit të ditës, për këmbimin e pronës komunale me pronë private, por e cila është proceduar pas afatit ligjor dhe nuk po respektohet rregullorja e punës së kuvendit sepse të gjitha pikat e rendit të ditës duhet të kalojnë nëpër Komitetin për Politikë dhe Financa; dhe pyeti se kjo pikë a ka kaluar përmes zyrës së kryesueses dhe përse pika kaq të ndjeshme po procedohen në mënyrë kaq të ngutshme duke mos pasur mundësi që ato të analizohen fare, ku qëndron problemi, çfarë po fshihet, kush ka interesa personale për ndërrimin e këtyre pronave. Prandaj kërkoj nga kryesuesja e kuvendit që këtë pikë ta tërheqë nga rendi i ditës dhe për këtë vota e tij do të jetë kundër kësaj pike. Pastaj shtoj se komisioni i aksionarëve të N.L.P. "Përparimi" janë të pandërgjegjshëm dhe nuk po i kryejnë obligimet e tyre sipas ligjit, kjo dëshmohet me faktin se nuk po e procedojnë raporti para kuvendit për disa seanca më radhë edhe pse kanë obligim ligjor për një gjë të tillë. Prandaj kërkoj që të futet në rendin e ditës propozimi për shkarkimin e këtij komisioni të aksionarëve të N.P.L. "Përparimi".
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-** duke iu adresuar kuvendit dhe qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë deklaroi se: arsimin e ka pasur dhe ka prioritet qeverisës dhe vlerësoi se për këto vite sa ka qeverisur ai, ka bërë më shumë se sa qeveritë e kaluar, kjo dëshmohet se është ngritur numri dhe vlera e bursave për nxënësit dhe studentët e Komunës së Vushtrrisë dhe atë nga 70 bursa sa ishin në 100, dhe vlera nga 400 € në 600 € aktualisht. Pastaj ka mbështetje për arsimin edhe sa i përket profileve profesionale ku 11 prej tyre janë krejtësisht pa pagesë në qendrat e ndryshme të trajnimit të licencuara dhe të akredituara. Jemi komuna e parë në Republikën e Kosovës që kemi filluar mësimin dual, dhe gjithë ata nxënës që janë përfshirë në këtë proces i kanë orët praktike, pagesën dhe shujtën ditore por më e rëndësishmja është se për këta nxënës do të sigurohet një vend pune nga ana e kompanive të përfshira. Pastaj është bërë organizmi i garave të diturës dhe janë motivuar nxënësit dhe mbështetur të gjithë ata nxënës që kanë zënë vendin e parë të dytë dhe të tretë duke ju dhënë një shpërblim në para, por janë mbështetur edhe mësimdhënësit. Tani do të bëhet përzgjedhja e dy mësimdhënësve që do të merren me përgatitjen e nxënësve për regjistrim në Fakultetin e Mjekësisë, njëri në lëndën e biologjisë e tjetri në lëndën e kimisë, që janë lëndë

bazike për këtë drejtim, këta mësimdhënës do të paguhen nga komuna duke i hequr nxënësit nga pagesa e kurseve për përgatitje për provim pranues. Po ashtu komuna e Vushtrrisë ka mbuluar koston e kontratës kolektive për mësimdhënësit tanë edhe pse këtë është dashur të mbuloj MASHT-i, dhe kjo ka pasur një kosto gati të papërballueshme për komunën tonë. Lidhur me lirimin nga detyra të drejtorëve komunal, sqaroj se kjo është detyrë dhe e drejt ekskluzive e kryetarit të komunës, dhe i ka liruar ata drejtorë që kanë pasur angazhime tjera në sferën e tyre të karrierës apo plane tjera në jetën personale-private, por e mira e gjithë kësaj është se në këto vite qeverisje nuk ka pasur asnjë aferë korruptive nga ana e drejtorëve të emëruar nga ana e tij dhe për këtë ndihet shumë i lumtur. Tutje në këtë kontekst shtoj se sektori publik tashmë nuk është atraktiv për punësim sepse konkurrenca e ka bërë të vetën sepse në sektorin privat motivimi dhe pagesat po jenë shumë më të mira. Çështja e themelimit të drejtorive komunale, është e paraparë me statutin e komunës që është votuar në këtë kuvend dhe numri maksimal është 14 drejtori komunale dhe për këtë është bërë edhe organogrami, ku janë përshkruar detyrat dhe përgjegjësit dhe normalisht se do të themelohet edhe Drejtoria për Çështje të Diasporës sipas statutit të komunës. Lidhur me shpenzimin e buxhetit vlerësoi se ai është shpenzuar në masën 95% edhe pse ka pasur edhe borxhe që është dashur të paguhen. Ndërtimi i sheshit në Vushtrri dhe parkingu nëntokësor janë projektet shumë të rëndësishme dhe me vlerë për Komunën e Vushtrrisë, ndërsa ai adresoj kritika për qeverinë e kaluar se nuk ka bërë asgjë në rregullimin e sheshit duke mos i hequr as kabllot që ishin mbetur aty për vite të tëra dhe ato u hiqen pikërisht në mandatin e tij. Projekti i parkingut nëntokësor do të jetë projekt mjaft me vlerë dhe do sigurohen parkingjet nëntokësore në zemër të qytetit. Sa i përket ofrimit të ndihmës financiare për biznese në sheshin e qytetit që janë prekur nga punimet në atë pjesë ajo ndihmë do të kalkulohet për muajt që kanë pasur humbej dhe këto biznese do të kompensohen për humbjet që kanë pësuar, ndërsa ai propozim do të sillet para kuvendit. Kur bëhet fjalë me çështjen e kostos së sheshit dhe parkingut nëntokësor, të ngritur nga deputetja znj. Gashi, vlerësoi se ai që ja ka dhënë letrën për ta lexuar ai i mban mendët vetëm te tenderët, por nuk është korrekt dhe i saktë pretendimi për fryrje të kostos, sepse në këto projekte nuk figuron vetëm parkingu por komplet trajtimi i sheshit të qytetit. Lidhur me raportin për punën e Ndërmarrjes "Përparimi", ai raport është dashur të procedohet në kuvend. Nga sekretaria e kuvendit kërkoj të japin mendim profesional se çfarë është vota "për" vota "kundër", "abstenim" dhe mos-pjesëmarrje në votim. Mandej për furnizim me ujë të pijes, sqaroi se në qeverinë e kaluar ishte vendosur taksa për qytetaret për kyçje, në rrjetin e ujësjellësit në shumë prej 80€, konkretisht nga ish-drejtori i Shërbimeve Publike Refik Maloku por tani është hequr ajo taksë. Në mandatin e kaluar janë vendosur pompat për përcjelljen e ujit në distancë nga prej 1500 metra larg nga rrjeti kryesor që nuk ka gjasa të shkoi uji, dhe tani është montuar pompa e dytë që është afër gypit kryesor të ujësjellësit për atë pjesë dhe është duke u punuar edhe për pjesët tjera, dhe shpreson që shumë shpejt do të lëshohet uji. Deklaroi se e mbështetë propozimin që të lirohen nga pagesa e taksës për mbeturina, për punëtoret e Ndërmarrjes "Uniteti", por kjo do të bëhet në kuadër të ndryshimit të rregullores për mbeturina.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-**tha se, e përshëndet propozimin e kryetarit të komunës që të kemi një staf për përgatitjen e nxënësve për provimin pranues në fakultetin e Mjekësisë, por sugjeroi që ai panel të zgjerohet edhe me mësimdhënës nga lëndët matematikë, gjuhë shqipe dhe gjuhë angleze, ashtu që të plotësohet mozaiku i njohurive të përgjithshme-bazë.

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**ishte konciz dhe i qartë në pyetjen e tij drejtuar kryetarit të komunës, se a mund të ushtroj pozitën e drejtorit të një shkolle, individët që në tri vitet e fundit kanë mbajtur pozita politike në tri vitet e fundit, kërkoj përgjigje të qartë që të evidentohet në procesverbal.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**tha se, propozimi për fakultet të Mjekësisë është propozim me vend dhe e mbështesin, por i njëjti është në programin e LDK-së në Vushtrri, është mirë që ai është kopjuar. Lidhur me themelimin e drejtorive komunale ceku se ato janë me statut të komunës, por jo të gjithë e kanë votuar atë statut, ndërsa ceku se themelimit të këtyre drejtorive duhet t'iu paraprijë buxheti dhe vendet e punës duhet paraprakisht të planifikohen në buxhet.
**Edona Gashi, anëtare e kuvendit-**kërkoi të kenë një raport të zgjeruar lidhur me koston e projektit ndërtimi i sheshit në Komunën e Vushtrrisë dhe atë koston financiare për secilin pozicion të këtij projektit si për parkingjet, ashtu edhe për amfiteatrot dhe pjesët tjera të sheshit që lidhen me këtë projekt.
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**njoftoi kryetarin e komunës se mësimi dual është i organizuar nga MASHT-i edhe ai nuk bie në kompetencat e komunave, me vendim të ministrisë janë shtatë profile në nivel vendi që organizohen nga kjo e fundit. Sa i përket kontratës kolektive të arsimit ku u deklarua se obligimet duhet ti merr Ministria e Arsimit, kjo nuk është kështu sepse komunat i kanë bartur obligimet, ndërsa ajo është lidhur me SBASHKU-n dhe MASHTI-n. Ndërsa mësimdhënësit janë dëmtuar financiarisht në realizimin e kësaj kontrate sepse kanë hequr dorë nga kamata.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**tha se, nuk ka motiv të replikoj me askënd në kuvend, por kur tentohet të dezinformohet kësisoj opinioni publik, duhet të reagoj, ku deklaroi se: është e pandershme kësisoj të hidhet pluhur syve, sepse rrezikun e pagesës së kontratës kolektive për mësimdhënësit e komunës sonë e ka marr personalisht ai, si rrallë nga kryetarët e komunave, sepse e njëjta ka barrë të rënd financiare dhe mund ti rrezikoj seriozisht financat e komunës. Prej kamatës kanë hequr dorë avokatët sepse kanë pasur të paguhen për çdo seancë, nëse do të aplikohen prapësimi apo ankesa, prandaj mos i dezinformoni mësimdhënësit. Sa i përket mësimit dual, vendimet e MASHT-i ekzekutohen në komunat e Kosovës, ndërsa ai ka negociuar për lidhjen e bashkëpunime me operator ekonomik për mësimin dual, për praktika profesionale. Lidhur me pyetjen e z. Mehollli, ceku se, paneli-komisioni, përzgjedhës gjatë punës për rekrutimin e drejtorëve të shkollave, duhet të ketë pasur për bazë këto vërejtje e ndër to edhe çështjen e politizimit dhe zgjedhjen e drejtorëve apolitikë, por për këtë ekziston edhe Agjencia Kundër Korrupsionit dhe gjykata, se nëse ka pasur shkelje atëherë ato do të konstatohen. Lidhur me kërkesën e znj. Gashi, për raport të zgjeruar, sqaroi se për këtë çështje ekziston projekti në mënyrë specifike që është i publikuar në faqen e komunës, në mënyrë mjaft specifike dhe të cilës mund t'i qaseni.
**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-**tha se, përkrahë mendime që të largohet nga rendi i ditës propozim-vendimi për këmbimin e pronës komunale me pronën private, për faktin se është krijuar një shprehi e keqe që po vinë pikat para fillimit të mbledhjes dhe kjo është kundër statutit dhe rregullores. Këto gjëra po ndodhin kryesisht për dy arsye, njëra sepse pushteti ka mungesë të numrave edhe në KPF dhe në kuvend, dhe arsyeja e dytë është për të tentuar të mjegullohen gjërat. Ekziston interesi personal që kolegut të dikujt z. Adnan Lahu ti shtohet rruga dhe rregullimi i infrastrukturës që kolegu i tij të marr parcelën. Në fund tha se z. Lahu gjithë ditën bredhë poshtë e lartë nëpër kafenetë e qyteti duke bërë pazare.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**apeloj tek kryesuesja e kuvendit që ti merr përgjegjësit e saj në udhëheqjen e mbledhjeve të kuvendit, duke zbatuar statutin dhe rregulloren e kuvendit, dhe po ashtu ceku se duhet të plotësohet vendi vakant në Komitetin për Politikë dhe Financa, sepse ai është institucion dhe nuk është pronë e asnjë partie politike që të mbetet jo funksional. Më tej shprehu pakënaqësitë e tij lidhur me fotografitë zyrtare të mbledhjes së KPF-së, të cilat nuk

shpërfaqin anë reale të këtij forumi me rëndësi për komunën. Prandaj vlerësoi se është e pa dinjëtetshme vlerësimi që i bëhet komitetit në veçanti dhe kuvendit në përgjithësi.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**duke polemizuar me anëtarin e kuvendit z. Faton Hyseni, shtoi se ky i fundit për më tepër se dy vite ka votuar me sy mbyllur dhe as që i ka lexuar materialet se çfarë po voton. Tutje shtoi se kush bënë pazare krejt e dimë dhe e dimë se cilat pazare i ka bërë edhe z. Faton. Pastaj shtoi se, pika që ka të bëj me këmbim të pronës është një kërkesë e kahmotshme, gati qe 15 vite dhe e njëjta duhet të mbështet dhe jepet drejtim i duhur duke e aprovuar për shqyrtim në rendin e ditës.
**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-**tha se, krejt e njohin Adnan Lahun dhe krejt e dinë se kush bënë pazare, sepse ai bënë pazare edhe në kurriz të kryetarit të tij në parti, bile ka pasur pretendime edhe të bëhet kryetar i partisë por nuk pati mbështetje në anëtarësi.
**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-**përsëriti, duke kërkuar që pika e rendit të ditës këmbimi i pronës komunale të shtyhet për mbledhje e ardhshme ashtu që e njëjta ti kaloj filtrat e duhur dhe kësisoj kjo çështje të votohet dhe aprovohet në mënyrë krejt ligjore. Ndërsa propozoi që të vihet në votim propozimi për shkarkimin e komisionit të aksionarëve të N.P.L. “Përparimi”, sepse i njëjti është i papërgjegjshëm ndaj kuvendit dhe organeve tjera. Më tej ai shtoj se nuk merre porosi dhe letra nga anëtarët e qeverisë dhe ti lexoj ato para kuvendit duke qenë i shantazhuar.
**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-**tha se, duke u bazuar në neni 30 pika 2 e Rregullores për Punën e Kuvendit, citoj: *Në raste urgjente kryesuesi/ja i/e kuvendit në bashkëpunim me kryetarin e komunës mund të procedojnë materiale për pika shtesë të rendit të ditës, të cilat nuk kanë kaluar përmes Komitetit për Politikë dhe Financa.* Prandaj, propozimi për këmbimin e pronës komunale është në përputhje të plotë me rregulloren dhe kjo mbetet në vullnetin e anëtarëve të kuvendit. Lidhur me themelimin e drejtorive komunale, vlerësoi se statuti i komunës është aprovuar me 2/3 e votave të anëtarëve të kuvendit dhe bazuar në këtë statut numri i drejtorive është paraparë deri në 14 drejtori.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**tha se, nuk paraqet ndonjë problem edhe nëse hiqet nga rendi i ditës propozimi për këmbimin e pronës komunale, edhe pse ky propozim është ligjor, por i njëjti duhet të kaloj filtrin e Komitetit për Politikë dhe Financa. Ai kërkoj që të kemi qasje pozitive mes veti dhe mos të tentohet të goditen ndër veti, por të ruhen raportet me njëri tjetrin.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**propozoi që të futet në rendin e ditës propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendit vakant në Komitetin për Politikë dhe Financa.
**Remzi Ahmeti, drejtor i DGJKP-së-**paraqiti sqarime lidhur me çështjen e këmbimit të pronës mes Komunës së Vushtrrisë dhe peronit privat, duke cekur se sipërfaqja është e njëjtë dhe nuk ka kurrfarë pengese që kjo çështje të procedohet për votim.
**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-**tha se, kjo pikë duhet të sillet e pasqyruar edhe me ajër fotografim dhe me ngjyra ashtu që të dihet saktë se me kënd kufizohet kjo pronë dhe kush po përfiton nga ky këmbim.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**kërkoj që pika lidhur me këmbimin e pronës komunale me pronën private të mos hedhet fare në votim, e njëjta të përgatitet për mbledhjen e ardhshme në formën si po kërkohet nga anëtarë e kuvendi dhe më pas të aprovohet.
**Mentor Hasani, anëtar i kuvendit-**në emër të grupit kuvendar të LVV-së kërkoj dhjetë minuta pauzë për konsultim.

*Në vazhdim kuvendi pas votimi me 7 vota “për” 13 vota “kundër” dhe 1 votë “abstenim” nuk e aprovoj për inkorporim në rendin e ditës propozimin për shkarkimin e Komisionit të Aksionarëve të N.P.L. ”Përparimi”.*

*Kuvendi pas votimit me "për" me 20 vota "për", 6 vota "abstenim" e aprovoi për inkorporim në rendin e ditës propozimin për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit lidhur me themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.*

**Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me vota "unanime" aprovoi këtë:**

**R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 28 mars, 2024.
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit tremujor të shpenzimeve për periudhën Janar – Mars 2024.
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft–Planit të veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë 2024-2026.
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit lidhur me themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.
5. Pyetje dhe përgjigje.

**1.** Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 28 mars, 2024.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota "unanime", aprovoi procesverbalin nga mbledhja rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datën 28 mars 2024.**

**2.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit tremujor të shpenzimeve për periudhën Janar – Mars 2024.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**tha se, ky raport për periudhën janar-mars 2024 na tregon se buxheti i planifikuar për investime kapitale ka qenë 6,864.33 €, ndërsa të shpenzuara kanë qenë 6,243.986 €, apo shprehur në përqindje 91%. Në këtë periudhë raportuese pak kemi realizim të projekteve, por një përqindje kaq e larët e shpenzimit të buxhetit është si pasojë që përmbaruesi privat i ka marr komunës mbi 1 milion euro për kryerjen e obligimeve për punëtorët e arsimit, obligime këto që burojnë nga kontrata kolektive e nënshkruar gjatë vitit 2017. Pra, buxheti është shpenzuar, por lagje të tëra ende janë pa ujë të pijes. Fshatrat si Gracë, Stanoc i Epërm, Maxhunaj, Dumnicë, Druar, Ceceli, Ropicë, Vilanc dhe Samadrexhë e fshatra tjera, janë akoma pa ujë të pijes. Mandej shumë rrugë që kanë filluar vitin e kaluar të ndërtohen kanë mbetur pa u përfunduar si rezultat i mungesës së mjeteve financiare. Po ashtu, shumë lagje të komunës sonë ende nuk kanë ndriçim publik, por edhe në lokalitetet ku ekziston ndriçimi ai nuk është funksional për shkak të defekteve dhe mos intervenimit me kohë për rregullimin e tij nga ana e organeve përgjegjëse. Në këtë kontekst kërkoj nga DSHP-ja që të merret me kërkesat e banorëve të fshatit Gracë për rregullimin e pompës së ujit, sepse këta banorë ende nuk kanë ujë të pijes si rezultat i këtij defekti. Po ashtu ngriti çështjen lidhur me problemin në shkollën fillore "Migjeni", në fshatin Stanoc i Epërm, për shkak të kundërmimit të një ere të pakëndshme, andaj kërkoj nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, të intervenoj sa më parë në zhbllokimin e kanalizimit ashtu që të evitohet kjo erë e pakëndshme.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 22 vota “për”, 4 vota “abstenim”, aprovoj Raportin tremujor të shpenzimeve për periudhën Janar – Mars, 2024.**

**3.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft–Planit të veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë, 2024-2026.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**tha se, në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Arsimin Parauniversitar si dhe akteve tjera nënligjore, parashihet e drejta në qasje të barabartë në arsim, pa dallime. Legjislacioni në fuqi i obligon institucionet arsimore si MASHT-i dhe komunat që të ofrojnë arsim cilësor, gjithëpërfshirës, humane dhe të sigurta. Më tej shtoj se e ka lexuar këtë plan dhe vlerësoi se është një bazë e mirë që do të ndikoj në kompletimin e rregullimit të kësaj fushe. Sugjeroi që në aspektin e parandalimit të braktisjes së nxënësve nga procesi shkollor dhe mos regjistrimi, të kenë koordinim të përpjekjeve të gjithë së bashku, ashtu që të ulet numri i nxënësve që braktisin shkollimin, sidomos shkollimin obligues. Tutje ngriti disa çështje në referencë faqe 6, ku cekte se numri i nxënësve që kanë braktisur shkollimin gjatë vitit të kaluar në klasat I-IX është 1 deri në 5 nxënës, por që kjo është një fjali pakuptim sepse duhet të dihet saktë se cili është numri i këtyre nxënësve. Pastaj në këtë dokument thuhet se numri i nxënësve në klasë X-XII në shkollat e mesme të larat është më i madh dhe thuhet se është deri në 19 edhe këtu duhet të kemi një shifër të saktë. Gjithashtu në faqe 6, në një fjali thuhet se të gjitha shkollat në qytet kanë psikologun e shkollave, kjo është mirë, mirëpo kjo është një diskriminim sepse shkollat në fshatra në shumicën e tyre nuk kanë psikolog të shkollës. Te sfidat ku thuhet se kemi një fond prej 1800 €, kërkoj që ky fond të rritet, ashtu që të mund të kryhen funksionet që dalin nga plani me qëllimin e parandalimit të dukuris së braktisjes dhe mos regjistrimit në shkollë. Në faqen 8 thuhet se, ekipi kundër braktisjes raporton në baza gjashtëmujore dhe vjetore, por këtu do kishte me qenë mirë që ekipi të marr informata nga shkollat e komunës dhe të raportoj në baza mujore. Në informatën e muajit të kaluar lidhur me përfundimin e gjysëmvjetorit të parë të vitit shkollor 2023/2024, tek aktivitet thuhet se DKA-ja realizon vizita të rregullta në Qendrën Arsimore të Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas në Prelluzhë, në këtë draft thuhet se numri i nxënësve që kanë braktisur shkollimin këtë vit janë 2 deri në 5 dhe pyeti se a janë të përfshirë këtu edhe nxënësit nga këto komunitete pakicë sepse siç dihet këto komunitete kanë vështirësi në qasjen në shërbime në përgjithësi edhe në fushën e arsimit në veçanti.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim aprovohet Plani i Veprimit Kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës, 2024-2026.

**2.** Qëllimi i aprovimit të këtij plani është koordinimi i veprimeve ndërinstitucionale dhe ngritja e kapaciteteve në nivel lokal dhe shkollor në zbatim të detyrimeve ligjore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjitrimit të shkollës, duke rritur përfshirjen e fëmijëve në arsim dhe zvogëlimin e braktisjes.

**3.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria Komunale e Arsimit si dhe drejtoritë e tjera kompetente, komunale.

**4.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin, Plani i Veprimit Kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës, 2024-2026.

**5.** Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**4.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit lidhur me themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**tha se, krejt e kujtojmë se si është votuar dhe në fakt mbivotuar çështja e themelimit të Komiteteve të përhershme, e në veçanti si është votuar themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe për këtë arsye grupi kuvendar i LDK-së nuk do të marr pjesë në votim në shenjë pakënaqësie me formën se si janë bërë këto gjëra, me këto trupa të kuvendit.
**Mentor Hasani, anëtar i kuvendit-**në emër të grupit kuvendar të PDK-së, propozoi z. Mensur Kasumi, për anëtar të Komitetit për Politikë dhe Financa.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 16 vota "për", 10 vota "abstenim", vendosi si vijon:**

**1.** Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi i kuvendit me numër të protokollit 01.Nr.04/22 i datës 14.01.2022, lidhur me themelimin e Komiteti për Politikë dhe Financa; ashtu që në vend të z.Ilmi Azemi nga radhët e PDK-së emërohet z. Mensur Kasumi nga i njëjti subjekt politik.

**2.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

**3.** Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**5.** Pyetje dhe përgjigjje:

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-**tha se, para disa muajsh është marr një vendim nga kuvendi i komunës lidhur me objektin e QKMF-së në Vushtrri, por shtohet pyetja se a është mbledhur ndonjëherë ai komision, apo nuk ka mbajtur asnjë mbledhje, nëse është mbledhur ky komision pse nuk e sjellë raportin para kuvendit. Më tej është vendosur që lënda të dërgohet në hetuesi, prandaj pyet a ka shkuar kjo lëndë në hetuesi, nëse nuk është dërguar pse nuk është dërguar, nëse është shkuar pse nuk është sjellë raporti i hetuesisë?
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**pyeti se, si është mbetur çështja e votimit lidhur me shujtat e punëtorëve të administratës komunale, a ka kaluar filtrin dhe cili është fati i atij vendimi, është mirë që kjo çështje definitivisht të qartësohet, se ky vendim a konsiderohet se është aprovuar qoftë me vlerën prej 3 apo 4 euro, dhe nëse ka kaluar ky vendim i njëjti a do të zbatohet dhe kur do të zbatohet. Mandej çështja e subvencionimit për fëmijët e posalindur, që është votuar para disa seancave, e që prapë janë bërë kalkulime nga kryesuesja e kuvendit edhe pse ai vendim është aprovuar, mirëpo çështja kishte mbetur që të bëhet një analizë financiare nga ekzekutivi komunal,

sa a ka mjete për rritjen e këtyre subvencioneve nga 120 në 250 €, por që një informatë për një analizë të tillë asnjëherë nuk është ofruar para kuvendit.
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**pyeti lidhur me një deponi të mbeturinave në fshatin Stanoc i Epërm, që ndodhet te lagjja Haradinaj-Haxhaj, për të cilën kemi marrë premtime para dy apo tri seancave, se do të intervenohet dhe do të bëhet pastrimi i atij vendi, mirëpo ende nuk kemi asnjë veprim apo përgjigje për këtë çështje, dhe ajo që është edhe me keq është se këto mbeturina po shkaktojnë pengesa në rrugë për bujqit që i punojnë tokat e tyre në këtë lokalitet. Për këtë kërkoj që në mënyrë urgjente të ndërmerren veprim për rregullimin e kësaj problematike nga ana e drejtorisë kompetente.
**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-**pyeti kryesuesen e kuvendit se, përse nuk po iu siguroni pajisjet elektronike siç janë lap-top apo tablet për anëtarët e kuvendit, ashtu siç është e paraparë me rregulloren e punës së kuvendit.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**tha se, pajtohet që komisioni për konstatimin e gjendjes faktike në objektin e QKMF-së, të sjell raportin lidhur me të gjeturat në atë objekt, në seancën e ardhshme dhe më pas mund të dimë se a ka bazë që më tutje ta procedojmë në organet tjera këtë çështje. Sa i përket çështjes së shujtave potencoj se nuk e di nëse kjo çështje është kthyer nga mistria apo jo, dhe deklaroi se ky vit është ndër vitet më të vështira financiare për shkak të borxheve që i kemi paguar, dhe falë ndihmës që kemi pasur nga ana e ministrive të Qeverisë së Republikës së Kosovës, deri diku do ti mbulojmë këto mungesa financiare që i kemi. Lidhur me punëtorët e Ndërmarrjes "Përparimi" është duke e analizuar këtë çështje dhe do marrim bashkërisht një vendim për ti subvencionuar këta punëtor. *Lidhur me çështjen e subvencionimit për fëmijët e posalindur, kërkoj nga Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, që në seancën e ardhshme të kuvendit të bie një informatë-analizë financiare me shifra të sakta, ashtu që a kemi mundësi apo jo që të rriten subvencionet nga 120 në 250 € për këta fëmijë.* Lidhur me çështjen e deponisë së mbeturinave në fshatin Stanoc i Epërm, kërkoj nga Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike që në bashkëpunim me Kompaninë "Përparimi", por të kontaktohet edhe anëtari i kuvendit që vjen nga ajo anë dhe menjëherë të ndërmerren veprimet. Kërkoj nga të gjithë që të angazhohen në vetëdijesimin qytetar që mos të hidhen mbeturinat në vendet jo adekuate.
**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit-**sqaroi se, lidhur me çështjen e lap-topëve, për anëtarët e kuvendit, ka bërë kërkesë qysh në fillim të këtij mandati, por ishte bërë një gabim në performancat e atyre mjeteve elektronike dhe kjo kërkesë ishte kthyer mbrapsht. Po ashtu ka bërë kërkesë edhe për rregullimin e sallës së mbledhjeve të kuvendit dhe shpreson që kjo kërkesë të realizohet sa më parë. Lidhur me çështjen e shujtave për punëtorët e administratës së komunës, sqaroi se nuk ka dërguar vendim në MAPL, sepse votimi nuk ka qenë i rregullt, dhe për këtë çështje ajo do të propozoi që kjo çështje sërish të sillet në kuvend.

**Mbledhja përfundoi në ora 14:20**

| | |
|---|---|
| **Bastri Duraku** | **Melihate Basholli-Latifi** |
| ________________ | ________________________ |
| **Procesmbajtës** | **Kryesuese e Kuvendit** |

**Republika e Kosovës** **Kuvendi i Komunës Vushtrri**

Propozuesi :Kryetari i Komunës, Ferit Idrizi ____________

Hartuesi: Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, Remzi Ahmeti ____________

Lënda: Propozim-Vendim për këmbim të pronave.

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d, të Ligjit për Vetëqeverisjen lokale (nr.03/L-040), nenit 24, nenit 25 paragrafi 1,3,4 dhe 6 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, nenit 29, 30 dhe 31 të Rregullores (QRK)nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të pronës së Paluajtshme të Komunës dhe të nenit 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në seancën e mbajtur më ________ 2024, mori këtë:

# V E N D I M

Për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për rregullimin e kanalizimit në rr. "Enver Musa" në Vushtrri

1. Miratohet propozimi i kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bekim, Kadri, Ferki dhe Isak Krasniqi, në pjesë ideale prej ¼.

2. Pronat e paluajtshme që do të këmbehen kanë këto karakteristika: pjesë nga parcela kadastrale P-70202016-01121-1,në sipërfaqe prej 65 m2, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 7074m2 zk Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë, me pjesën e parcelës kadastrale P-70202016-00939-2, në sipërfaqe prej 65m2, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 238m2 zk Vushtrri, pronë e Bekim, Kadri, Ferki dhe Isak Krasniqi me pjesë ideale ¼.

3. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për zgjerimin e rrugës publike në fjalë bazuar në profilin e rrugës sipas Planit Zhvillimor Komunal 2016-2024.

4. Këto prona ju janë nënshtruar vlerësimit të pronave nga Zyra për Vlerësimin e pronave të paluajtshme pranë Departamentit të tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe transfereve.

5. Pronat e paluajtshme që do të këmbehen, të përshkruara në pikën 2 të këtij vendimi, duhet të evidentohen në elaboratin kadastral (librat kadastral) të Komunës.

6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

7. Ku vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjet (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuese e Kuvendit**

________________________

Melihate Basholli-Latifi

# ARSYETIM

z. Bekim, Ferki, Isak dhe Kadri Krasniqi nga Vushtrria, me kërkesë ju kanë drejtuar Komunës së Vushtrrisë për këmbimin e pronës së tyre me pronën e Komunës së Vushtrrisë, pasi që Komuna e Vushtrrisë gjatë realizimit të projektit të rregullimit të kanalizimit në këtë pjesë të qytetit ka vendosur gypat e kanalizimit nëpër pronën e tyre.

Zyrtarët e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, kanë dalë në terren dhe kanë vërtetuar gjendjen faktike dhe kanë konstatuar se Komuna e Vushtrrisë gjatë realizimit të projektit në fjalë ka vendosur gypat në pronën e z. Krasniqi në sipërfaqe prej 65m2.

Drejtoria për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë i propozon Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë qe ta aprovojë këtë propozim – vendim.

Andaj në bazë të cekurave më lartë konsiderojmë se janë plotësuar kushtet për këmbimin e pronës komunale dhe i propozojmë Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë ta aprovoi këtë propozim vendim si në dispozitiv.

**Drejtori i Drejtorisë**

_______________

**Remzi Ahmeti**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive
09/465 Nr. Prot. 970-2/2023
97 Data 26.02.2024
PRISHTINË/A

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers*

*Departamenti për Vlerësimin e Pronave te Paluajtshme*

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | 26.2.2024 |
| **REFERENC-Ë:** | 970-2/2023 |
| **PËR/ZA/TO:** | Ferit IDRIZI, Kryetar i Komunës – Vushtrri |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | |
| **CC:** | Enis SPAHIU, U.D Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve |
| **NGA/OD/FROM:** | Albana SHALA-BUNJAKU, U.D Drejtoreshë e Departamentit për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme<br>Florije ZABËRGJA, Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim në Departamentin për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Dorëzim i Raportit të Vlerësimit** |

I nderuar Kryetar,

Në vijim të kërkesës së bërë nga Komuna e Vushtrrisë , me subjekt: Kërkesë për vlerësim te pronës së paluajtshme, referencë nr. 1303/23 Datë 08.11.2023 (Pranuar në MFPT 970/2023 prot. Datë 14.11.2023) dhe plotësuar kërkesën referencë 08 nr.704 (Pranuar në MFPT 970-2/2023 prot. Datë 28.12.2023), në zbatim të ligjit Nr. 03/l-139, Datë 26.03.2009 "Për shpronësimin e pronës së paluajtshme", me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe në zbatim të Ligjit NR. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës". Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim në Departamentin për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme, ka finalizuar procedurën për vlerësim sipas kërkesës.

Për vlerësimin e pronave te paluajtshme, stafi i DVPP-se, filluan punën për inspektimin e pronave, përcaktimin e vendndodhjes dhe mbledhjen e informacionit përkatës, për te dhënat e tregut ne zonën përreth pronave, te cilat vlerësohen me qëllim Këmbimi.

Gjate inspektimit u kryen verifikimet për pronat që do te vlerësohen, u përcaktua vend ndodhja e pronës, fotografimet e zonës dhe parcelave, gjendja e pronës, etj.

Raportet e Vlerësimit janë hartuar bazuar në:
- Ligjin Nr. 03/I-139, Datë 26.03.2009 "Për shpronësimin e pronës së paluajtshme", me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij

- Udhëzimi Administrativ MF - Nr. 02/2015 *Për Miratimin e Metodave dhe Kritereve Teknike të Vlerësimit për Përllogaritjen e Shumës së Kompensimit për Pronën e Paluajtshme që Shpronësohet, dhe Dëmeve që kanë të Bëjnë me Shpronësimin;*

-Ligjin NR. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës";

Bashkëlidhur kësaj shkrese po ju përcjellim:

a.) Të dhënat e pronave dhe pronareve ( sipërfaqja totale, sipërfaqja që vlerësohet dhe shuma për kompensim), ne formë tabelare 2 kopje fizike .

b.)Përshkrimin e metodologjisë së përdorur për kryerjen e vlerësimit;

c.) Vlerën e përgjithshme të pronës e cila është objekt i vlerësimit së bashku me një përshkrim të komponentëve përbërës të vlerës (Raporti i Vlerësimi 2 kopje

Me respekt!

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

***Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve***

***Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers***

Departamenti pë Vleresimin e Pronave të Paluajtshme

Odeljenje za Procenu Nepokretnosti - Immovable Property Appraisal Department

| Komuna: Vushtrri Zona Kadastrale: Vushtrri | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Të dhënat sipas Elaboratit / Certifikatës së Pronës | | | | | Vlerësimi | |
| Nr. | Pronar/Posedues | Numri i pronës | Kultura / Klasa-Shfrytëzimi aktual | Sipërfaqja e Përgjithshme $m^2$ | Sipërfaqja për vlerësim $m^2$ | Çmimi i tokës ( €/$m^2$) | Totali ( € ) |
| 1 | KOMUNA E VUSHTRRISE | 1121-1 | Infrastrukturë/Rrugë e Pakategorizuar | 7074 | 65 | 170.00 | 11.050.00 |

Aprovoi date: 26/02/2024

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve*
*Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers*
*Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme*
*Odeljenje za Procenu Nepokretnosti- Immovable Property Appraisal Department*

# RAPORT – VLERËSIMI

*Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim*

Numri i pronës: 1121-1 Zona Kadastrale: Vushtrri Datë: 26.02.2024

## H Y R J A

Më datë 12.01.2024 në mbështetje të nenit 22. paragrafi 3 i ligjit Nr. 03/l-139, Datë 26.03.2009 "Për shpronësimin e pronës së paluajtshme", të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe në zbatim të Ligjit NR. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim në Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme, mori në shqyrtim kërkesën referencë 1303/23 Datë 08.11.2023 (Pranuar në MFPT 970/2023 prot. Datë 14.11.2023) dhe plotësuar kërkesën referencë 08 nr.704 (Pranuar në MFPT 970-2/2023 prot. Datë 28.12.2023) që i përket subjektit:

**Komuna: Vushtrri**

**Me objekt kërkese** : Kërkesë për vlerësim te pronës së paluajtshme

# PËRMBAJTJA

**Prona:** **1121-1**

**Pronar:** KOMUNA E VUSHTRRISE

**Adresa:**

**Zona Kadastrale:** Vushtrri

**Komuna:** Vushtrri

**Data e Inspektimit: 21.02.2024**

**Data e Raportit: 26.02.2024**

**Përgatiti raportin:** DIVIZIONI PËR VLERËSIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME PËR SHPRONËSIM DHE KËMBIM

**Vlera e pronës së paluajtshme: 11,050.00 €**

## I. LIGJET E APLIKUESHME

Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim në Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme, ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe brenda kufijve të kompetencave që i janë dhënë përmes ligjit.

Në zbatim të nenit 21 të ligjit Nr. 03/I-139, Datë 26.03.2009 "*Për shpronësimin e pronës së paluajtshme*", të ndryshuar, Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim në Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme, ka kompetencën ekskluzive për vlerësimin e të gjitha pronave të paluajtshme të cilat janë objekt i procedurës së shpronësimit dhe llogaritjen e dëmeve që kanë të bëjnë shpronësimin, nga cilido organ shpronësues.

Si dhe akti nënligjor i cili derivon nga Ligji Udhëzimin Administrativ nr 02/2015 të miratuar nga Ministria e Financave " *Për miratimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin*".

Po ashtu me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunes", Divizionit për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim në Departamentin për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme i është shtuar edhe përgjegjësia e vlerësimit të pronave të paluajtshme nen administrimin e AKP-së dhe Komunave, te cilat propozohen të këmbehen midis tyre dhe Këmbimi i pronës komunale me persona fizik dhe juridik.

Me qëllim të interpretimit dhe zbatimit të këtij raporti, termet dhe shprehjet, kurdo që përdoren në këtë raport, kanë kuptimin e përcaktuar më poshtë, përveç nëse konteksti në të cilin këto terme ose shprehje përdoren, qartësisht kanë kuptim tjetër:

**"Pronë e Paluajtshme"** nënkupton
(i) tokën,
(ii) ndërtesat ose pjesët e veçanta të një ndërtese të ndërtuara në, mbi ose nënsipërfaqen e tokës si dhe
(iii) pjesët përbërëse dhe sendet akcesore tëcilat i janë bashkuar tokës ose ndërtesës në bazë të përhershme dhe të cilat nuk mund të largohen pa përpjekje të paarsyeshme ose jo-ekonomike, dhe
(iv) frutat e pa shkëputura nga toka."

**" Pronë e paluajtshme e Komunës"** – pronë e paluajtshme e regjistruar në emër të komunës në Regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme.

" **Këmbimi**" - e drejta e Komunës për të bërë ndërrimin e pronës së paluajtshme të Komunës me personat fizik dhe juridik.

## II. TË DHËNAT MBI PRONËN SIPAS ÇERTIFIKATËS MBI TË DREJTAT E PRONËS SË PALUAJTSHME/ELABORATIT:

| |
|---|
| Nr. i pronës:1121-1 |
| Zona Kadastrale: **Vushtrri** |
| Komuna: **Vushtrri** |
| Pronari: KOMUNA E VUSHTRRISE |
| Sipërfaqja: 7074m² |
| Kultura/Klasa : Infrastrukturë/Rrugë e Pakategorizuar |

## III.PËRSHKRIMI I ZONËS PËRRETH PRONËS SË PALUAJTSHME DHE TË DREJTVAE QË PREKEN NGA PROCESI I KËMBIMIT

Vushtrria është qytet antik por edhe modern, ndodhet në pjesën veriore të Republikës së Kosovës. Vushtrria e sotme më herët është quajtur Vicianum.

Në veri kufizohet me Mitrovicën, në lindje me Besianën, në jug me Kastriotin, në jug-perëndim me Drenasin dhe në perëndim me Skenderajn. Sipërfaqja e tërësishme e saj përfshin 345 km². Ndërkaq, vlerësohet të ketë rreth 69.881 banorë, nga të cilët mbi 92% shqiptarë. Nën administrimin e Kuvendit Komunal të Vushtrrisë janë të përfshira 67 fshatra.

Qytetin e Vushtrrisë e përshkojnë lumi Sitnica, si lumi më i madh, që përshkon tejpërtej territorin e Komunës, ndërsa dy lumenj më të vegjël : Tërstena dhe Studimja, kalojnë nëpër qytetin e Vushtrrisë.

Për vlerësimin e pronës se paluajtshme, stafi i Divizionit për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim, filluan punën për inspektimin e pronës , përcaktimin e vendndodhjes dhe mbledhjen e informacionit përkatës, për te dhënat e tregut ne zonën përreth pronës, e cila është objekt këmbimi.

Gjate inspektimit u kryen verifikimet për pronën që do te vlerësohet, u përcaktua vend ndodhja e pronës, fotografimet e zonës dhe parcelave, gjendja e pronës, etj.

Prona me numër 1121-1 me kulturë "Infrastrukturë/Rrugë e Pakategorizuar", ndodhet ne Zonën Kadastrale Vushtrri, përkatësisht ne pjesën jugore te qytetit . Prona objekt i vlerësimit ka forme te çrregullt përkatësisht përdorej rrugë e cila përshkon një pjesë te kësaj zone. Bazuar ne gjendjen ne terren pjesa e pronës e cila këmbehet shtrihet ne brezin e pare te rrugës " Enver Musa", dhe përdorej për oborr te shtëpisë me banim individual. Sipas Planit Zhvillimor Komunal, destinimi për kete zonë është brenda Zonës Urbane –Qendra e qytetit me shfrytëzim te përzier. Afërsia me qendrën e qytetit dhe qasja ne infrastrukturë bën qe kjo zone te jete mjaft atraktive për zhvillimin e jetesës.

Në sipërfaqen e pronës objekt vlerësim, sipas elaboratit nuk ka "Pjesë aksesor" pjesët aksesore nënkuptojnë ndërtim, instalime, te cilat janë vendosur apo montuar në pronën e paluajtshme , për përdorim të përhershëm dhe të cilat nuk mund të shkëputen pa përpjekje ta pa arsyeshme ose jo ekonomike.

Në sipërfaqen e pronës objekt vlerësimi sipas elaboratit, nuk ka "Fruta"- që nënkupton frutat e pa shkëputura nga toka, bimësinë vjetore apo të përhershme , në një pronë të paluajtshme

## QËLLIMI I VLERËSIMIT

| | | |
|---|---|---|
| Shpronësim ☐ | <u>Këmbim</u> <u>x</u> | Servitut ☐ |

| SIPËRFAQET: | |
|---|---|
| Sipërfaqja totale: | 7074 m² |
| Sipërfaqja e vlerësuar për këmbim: | 65 m² |

| | |
|---|---|
| Prona është inspektuar me datën | 21.02.2024 |

## IV. ANALIZA LIGJORE E FAKTEVE

### Metodat e vlerësimit:

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Metoda e shitjeve krahasuese | ✓ |
| 2 | Metoda e kostos | |
| 3 | Metoda e të ardhurave | |

### Metoda e Shitjeve Krahasuese

Metoda e shitjeve krahasuese është metoda më e preferueshme për vlerësimin e pronave të paluajtshme, nëse ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme, brenda një periudhe të caktuar kohe, për shitblerjet që kanë ndodhur në një rajon të caktuar si dhe të dhëna për studimin e tregut.

### Vlera e Tokës Tjetër

1. Për përcaktimin e vlerës së tokës tjetër që nuk është tokë bujqësore, pyjore dhe ndërtimore, merren parasysh kriteret e mëposhtme:
   1.1. Madhësia e parcelës në $m^2$;
   1.2.Shfrytëzimi i vazhdueshëm i parcelës.

2. Përveç kritereve të mësipërme në përcaktimin e vlerës së tokës tjetër që nuk është tokë bujqësore, pyjore dhe ndërtimore, merren parasysh edhe kritere të tjera si kushtet mjedisore dhe kushtet e terrenit, nëse këto të fundit kanë një ndikim të dallueshëm në vlerësimin e pronës së paluajtshme.

## V. KONKLUZIONI

Për përgatitjen e këtij raporti është bërë inspektimi i pronës por nuk është kryer një mbikqyrje strukturore, si dhe në mungesë të të dhënave në elaborat nuk jemi në gjendje të raportojmë nëse prona ka ose jo difekte strukturore.

Raport vlerësimi është hartuar pas aprovimit të vleres se prones në tabela nga U.D Drejtoreshë e Departamentit për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme.

Bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.02/2015 të miratuar nga Ministria e Financave " *Për miratimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin*, neni 4, paragrafi 3.Vetëm në rastet kur në rajonin ku parashikohet të ndodhë shpronësimi për interes publik, mungojnë treguesit e shitblerjes, apo ka të dhëna të besueshme se këta tregues janë abusive dhe jo real, Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim mund të marrë të dhëna të nevojshme shtesë nga subjektet e listuara në nenin 17, paragrafi 3 i këtij udhëzimi.

Përkufizimi i "vlerës së tregut" është:

*"Vlera e tregut të pronës së paluajtshme nënkupton shumën e përafërt të vlerësuar për të cilën një pronë do të shkëmbehej në datën e miratimit të vendimit për autorizimin e kryerjes së punëve përgatitore ose në datën e paraqitjes fillestare të kërkesës, mes një shitësi dhe blerësi të vullnetshëm, përmes një transaksioni ku ata nuk kanë lidhje me njëri tjetrin, dhe pasi të jetë bërë marketingu i duhur ku secila nga të dyja palët ka vepruar në mënyrë të vetëdijshme, me maturi dhe pa ndonjë detyrim".*

Vlera e pronës së paluajtshme që është objekt i këtij vlerësimi, në përputhje me përkufizimet, analizat, dhe supozimet e më sipërme, pas aprovimit të vleres se prones në tabela nga U.D Drejtoreshë e Departamentit për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme, është:

| **Numri i pronës:** | **Sipërfaqja e vlerësuar(toka) m²** | **Çmimi për €/m²** | **Total Vlera e pronës €** |
|---|---|---|---|
| 1121-1 | **65.00 m²** | **170.00€/m²** | **11,050.00€** |

**Zyrtarët e DVPP-së:**

**Numri i licencës _ VP026**

**Numri i licencës _ VP099**

**Udhëheqësi i DVPP-së:**

**Numri i licencës _ VP004**

Aktit të vlerësimit i bashkangjiten dokumentat e mëposhtme:

1. Fotografitë e pronës së paluajtshme/zonës përreth
2. Dokumentacioni harto grafik. që përbëhet nga plani përkatës kadastral dhe harta e parcelës përkatëse:
3. Dokumentat e pronësisë.









Numri i pronës: 1121-1 Zona Kadastrale: Vushtrri Datë: 26.02.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70202016-01121-1

| | |
|---|---|
| Numri i Rastit / Broj Predmet / Case Referent Number: | Certificate draft |
| Data dhe koha e kërkesës / Datum i vreme podnošenja / Date and time of submission: | 07.12.2023 - 08:35 |
| Komuna / Opština / Municipality: | VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | Vushtrri / Vučitrn / Vushtrri |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI |

### A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona U/R<br>G/R<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m²) | Përshkrimi<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Urađjeno na dan<br>Created On | Azhurnuar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-70202016-01121-1 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | [illegible] | Urban | 7074 | | | |

### A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i njohur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Urađjeno na dan<br>Created On | Azhurnuar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| [illegible] | | | | |



### A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta korišćenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno korišćenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Infrastrukture / Infrastruktura / Infrastructure | Rrugë / Put / Road | | 7074 |

### B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Lični broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivalište<br>Residence | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Përshkrimi<br>Opis<br>Description | Azhurnuar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Državina / Single possession | Komuna e Vushtrrisë | [illegible] | VUSHTRRI / VUSHTRRI / VUSHTRRI / | | AHMET KRASNIQI | 1/1 | | |

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

***Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve***

***Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers***

Departamenti pë Vleresimin e Pronave të Paluajtshme

Odeljenje za Procenu Nepokretnosti – Immovable Property Appraisal Department

| Komuna: Vushtrri Zona Kadastrale: Vushtrri | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Të dhënat sipas Elaboratit / Certifikatës së Pronës | | | | | Vlerësimi | |
| Nr. | Pronar/Posedues | Numri i pronës | Kultura / Klasa-Shfrytëzimi aktual | Sipërfaqja e Përgjithshme $m^2$ | Sipërfaqja për vlerësim $m^2$ | Çmimi i tokës ( €/$m^2$) | Totali ( € ) |
| 1 | KOMUNA E VUSHTRRISE | 1121-1 | Infrastrukturë/Rrugë e Pakategorizuar | 7074 | 65 | 170.00 | 11.050.00 |

Aprovoi date:
26/02/2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve*
*Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers*
*Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme*
*Odeljenje za Procenu Nepokretnosti- Immovable Property Appraisal Department*

# RAPORT – VLERËSIMI

*Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim*

Numri i pronës: 939-2 Zona Kadastrale: Vushtrri Datë: 26.02.2024

## H Y R J A

Më datë 12.01.2024 në mbështetje të nenit 22, paragrafi 3 i ligjit Nr. 03/l-139, Datë 26.03.2009 "Për shpronësimin e pronës së paluajtshme", të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe në zbatim të Ligjit NR. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim në Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme, mori në shqyrtim kërkesën referencë 1303/23 Datë 08.11.2023 (Pranuar në MFPT 970/2023 prot. Datë 14.11.2023) dhe plotësuar kërkesën referencë 08 nr.704 (Pranuar në MFPT 970-2/2023 prot. Datë 28.12.2023) që i përket subjektit:

**Komuna: Vushtrri**

**Me objekt kërkese** : Kërkesë për vlerësim te pronës së paluajtshme

# P Ë R M B A J T J A

**Prona:** 939-2

**Pronar:** BEKIM KRASNIQI 1/4 ;
KADRI KRASNIQI 1/4;
FERKI KRASNIQI 1/4;
ISAK KRASNIQI 1/4

**Adresa:**

**Zona Kadastrale:** Vushtrri

**Komuna:** Vushtrri

**Data e Inspektimit:** 21.02.2024

**Data e Raportit:** 26.02.2024

**Përgatiti raportin:** DIVIZIONI PËR VLERËSIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME PËR SHPRONËSIM DHE KËMBIM

**Vlera e pronës së paluajtshme: 11,050.00 €**

## I. LIGJET E APLIKUESHME

Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim në Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme, ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe brenda kufijve të kompetencave që i janë dhënë përmes ligjit.

Në zbatim të nenit 21 të ligjit Nr. 03/I-139, Datë 26.03.2009 "*Për shpronësimin e pronës së paluajtshme*", të ndryshuar, Divizioni për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim në Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme, ka kompetencën ekskluzive për vlerësimin e të gjitha pronave të paluajtshme të cilat janë objekt i procedurës së shpronësimit dhe llogaritjen e dëmeve që kanë të bëjnë shpronësimin, nga cilido organ shpronësues.

Si dhe akti nënligjor i cili derivon nga Ligji Udhëzimin Administrativ nr 02/2015 të miratuar nga Ministria e Financave " *Për miratimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin*".

Po ashtu me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunes". Divizionit për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim në Departamentin për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme i është shtuar edhe përgjegjësia e vlerësimit të pronave të paluajtshme nen administrimin e AKP-së dhe Komunave, te cilat propozohen të këmbehen midis tyre dhe Këmbimi i pronës komunale me persona fizik dhe juridik.

Me qëllim të interpretimit dhe zbatimit të këtij raporti, termet dhe shprehjet, kurdo që përdoren në këtë raport, kanë kuptimin e përcaktuar më poshtë, përveç nëse konteksti në të cilin këto terme ose shprehje përdoren, qartësisht kanë kuptim tjetër:

**"Pronë e Paluajtshme"** nënkupton
(i) tokën,
(ii) ndërtesat ose pjesët e veçanta të një ndërtese të ndërtuara në, mbi ose nënsipërfaqen e tokës si dhe
(iii) pjesët përbërëse dhe sendet akcesore tëcilat i janë bashkuar tokës ose ndërtesës në bazë të përhershme dhe të cilat nuk mund të largohen pa përpjekje të paarsyeshme ose jo-ekonomike, dhe
(iv) frutat e pa shkëputura nga toka."

**" Pronë e paluajtshme e Komunës"** = pronë e paluajtshme e regjistruar në emër të komunës në Regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme.

**" Këmbimi"** - e drejta e Komunës për të bërë ndërrimin e pronës së paluajtshme të Komunës me personat fizik dhe juridik.

## II. TË DHËNAT MBI PRONËN SIPAS ÇERTIFIKATËS MBI TË DREJTAT E PRONËS SË PALUAJTSHME/ELABORATIT:

| |
|---|
| Nr. i pronës:939-2 |
| Zona Kadastrale: **Vushtrri** |
| Komuna: **Vushtrri** |
| Pronari: BEKIM KRASNIQI 1/4 : KADRI KRASNIQI 1/4; FERKI KRASNIQI1/4; ISAK KRASNIQI 1/4 |
| Sipërfaqja: 238 m² |
| Kultura/Klasa : Kullosë 3 |

## III.PËRSHKRIMI I ZONËS PËRRETH PRONËS SË PALUAJTSHME DHE TË DREJTVAE QË PREKEN NGA PROCESI I KËMBIMIT

Vushtrria është qytet antik por edhe modern, ndodhet në pjesën veriore të Republikës së Kosovës. Vushtrria e sotme më herët është quajtur Vicianum.

Në veri kufizohet me Mitrovicën, në lindje me Besianën, në jug me Kastriotin, në jug-perëndim me Drenasin dhe në perëndim me Skenderajn. Sipërfaqja e tërësishme e saj përfshin 345 km². Ndërkaq, vlerësohet të ketë rreth 69,881 banorë, nga të cilët mbi 92% shqiptarë. Nën administrimin e Kuvendit Komunal të Vushtrrisë janë të përfshira 67 fshatra.

Qytetin e Vushtrrisë e përshkojnë lumi Sitnica, si lumi më i madh, që përshkon tejpërtej territorin e Komunës, ndërsa dy lumenj më të vegjël : Tërstena dhe Studimja, kalojnë nëpër qytetin e Vushtrrisë.

Për vlerësimin e pronës se paluajtshme, stafi i Divizionit për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme për Shpronësim dhe Këmbim, filluan punën për inspektimin e pronës , përcaktimin e vendndodhjes dhe mbledhjen e informacionit përkatës, për te dhënat e tregut ne zonën përreth pronës, e cila është objekt këmbimi.

Gjate inspektimit u kryen verifikimet për pronën që do te vlerësohet, u përcaktua vend ndodhja e pronës, fotografimet e zonës dhe parcelave, gjendja e pronës, etj.

Prona me numër 939-2 me kulturë "Kullosë 3", ndodhet ne Zonën Kadastrale Vushtrri, përkatësisht ne pjesën jugore te qytetit . Prona objekt i vlerësimit ka forme te rregullt e cila përdorej për ooborr te shtëpisë me banim individual. Bazuar ne gjendjen ne terren pjesa e pronës e cila këmbehet ndodhet traseja e kanalizimit te qytetit. punimet per realizimin e këtij projekti ishin te përfunduara. Prona shtrohet ne pjesën e qytetit e cila sipas Planit Zhvillimor Komunal. destinimi për ketë zonë është brenda Zonës Urbane – Qendra e qytetit me shfrytëzim te përzier. Afërsia me qendrën e qytetit dhe qasja ne infrastrukturë bënë qe kjo zone te jete mjaft atraktive për zhvillimin e jetesës.

Në sipërfaqen e pronës objekt vlerësim. sipas elaboratit nuk ka "Pjesë aksesor" pjesët aksesore nënkuptojnë ndërtim. instalime. te cilat janë vendosur apo montuar në pronën e paluajtshme . për përdorim të përhershëm dhe të cilat nuk mund të shkëputen pa përpjekje ta pa arsyeshme ose jo ekonomike.

